



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.70, datë 06.12.2007

**“MBI FINANCIMIN E SHPENZIMEVE TE SHËRBIMIT FUNERAL TE TE  
NDJERES VIOLETA MANUSHI (ARTISTE E POPULLIT), TE KRYERA ME  
DATEN 27.07.2007”.**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 10, pika 3, paragrafi II, germa c, neni 19, pika 9 dhe neni 32, gërma dh, me propozim të një grupi këshilltaresh të Këshillit Bashkiak të Tiranës, si edhe të kërkesës së Fondacionit Kulturor Mbarëkombëtar “Nermin Vlorë Falaschi”, për financimin nga ana e Bashkisë së Tiranës të shpenzimeve të shërbimit funeral të të ndjerës Violeta Manushi (Artiste e Popullit), Keshilli,

**V E N D O S I**

1. Të financoje shpenzimet e shërbimit funeral të varrimit të të ndjerës Violeta Manushi (Artiste e Popullit), në masën 200.000 (dyqind mijë leke).
2. Shpenzimet prej 200 000 (dyqind mijë lekesh), të perballohen nga fondi rezervë, nga të ardhurat e Bashkisë - Tiranë për vitin 2007.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjehere.

Sokol Dervishaj

**K R Y E T A R**